



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

**Dokumenti nr: 21.4.9-2015/16-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PROCESI I RISHIKIMIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE**

*Auditim i performancës*

**Prishtinë, mars 2017**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe me praktikatat e mira evropiane.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të përshtatshme, janë kost- efektive dhe efikase, dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre janë funksionale.

Ky raport vlerëson aktivitetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në arritjen e objektivave të synuara në procesin e rishikimit të teksteve shkollë.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit të performancës "Procesi i rishikimit të teksteve shkollë" në konsultim me Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm, Artan Venhari dhe Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Mehmeti, të cilët e kanë mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Mirlinda Ahmeti, i mbështetur nga Drilon Shala (Udhëheqës i ekipit) dhe Fexhrie Thaqi (anëtare e ekipit).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	i
1 Hyrje.....	1
1.1 Problemi i auditimit.....	2
1.2 Objektivi dhe pyetjet e auditimit .....	3
1.3 Kriteret e auditimit .....	3
1.4 Fushëveprimi i auditimit .....	4
1.5 Metodologjia e auditimit .....	5
2 Subjektet kyçe dhe përgjegjësitë e tyre .....	6
2.1 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.....	6
2.2 Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore .....	7
2.3 Recensentët .....	8
2.4 Mësimdhënësit .....	8
3 Të gjeturat .....	9
3.1 Përmirësimi i pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet ekzistuese shkollore.....	9
3.1.1 Procesi i rishikimit .....	9
3.1.2 Përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve të KEPTSH.....	12
3.1.3 Ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore.....	13
3.2 Lehtësimi i çantës së shkollës.....	15
3.3 Kursimet buxhetore për botimin e teksteve shkollore .....	15
4 Konkluzionet .....	16
5 Rekomandimet .....	18
Shtojcat .....	19
Shtojca 1.....	19
Shtojca 2.....	20
Shtojca 3.....	21

---

## Përmbledhje e përgjithshme

### Çfarë kemi audituar dhe përse e kemi kryer këtë auditim?

Arsimi cilësor është e vetmja mënyrë për të rritur mundësitë e nxënësve për arsimim të mëtejshëm dhe për punësim më të mirë. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar. Cilësia në arsim është një çështje komplekse dhe është e lidhur edhe me qeverisjen dhe udhëheqjen, si dhe me infrastrukturën, përgatitjen dhe trajnimin e mësimitdhënësve si dhe cilësinë e kurrikulave dhe teksteve shkollore.

Për herë të parë pas dymbëdhjetë vjetësh, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2015 ka inicuar procesin e rishikimit të teksteve shkollore dhe për këtë qëllim në korrik të vitit 2015 ka themeluar Këshillin e Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore. Për të përmbushur synimet e Ministrisë për përmirësim të teksteve shkollore, Këshilli kishte përcaktuar fazën emergjente dhe atë substanciale. Në kuadër të fazës emergjente, Këshilli kishte për qëllim arritjen e tre objektivave si në vijim:

- përmirësimin e pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet shkollore,
- lehtësimin e çantës së shkollës, dhe
- kursimet buxhetore për botimin e teksteve shkollore.

Faza substanciale ka për qëllim inicimin e një cikli të ri të përpilimit të teksteve shkollore, në pajtueshmëri dhe sipas kërkesave të kurrikulës së re që pritet të implementohet për vitin shkollor 2017/2018.

Mediat e shkruara, raporte dhe ekspert të fushës së arsimit në vazhdimësi kanë theksuar dobësi lidhur me cilësinë e teksteve shkollore. Theks i veçantë i jepet prezencës së gabimeve teknike, përmbajtësore dhe shkencore në tekste si dhe mbingarkesës së tyre me përmbajtje të parëndësishme dhe të panevojshme. Shqetësuese mbetet edhe pesha e rëndë e teksteve shkollore si dhe shpenzimet e larta për botimin e tyre. Nisur nga rëndësia që ka arsimi cilësor në shoqërinë tonë dhe interesimi publik për të, Zyra Kombëtare e Auditimit është motivuar të kryej auditimin e performancës në këtë fushë.

Objektivë e auditimit është vlerësimi i aktiviteteve të ndërmarra nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, respektivisht Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore me qëllim të arritjes së objektivave të synuara gjatë procesit të rishikimit të teksteve shkollore.

Subjekt i auditimit është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Drejtoritë Komunale të Arsimit në komunën e Prishtinës, Gjilanit dhe Pejës si dhe katër shkolla në tre komuna: dy shkolla në Prishtinë, një në Gjilan dhe një në Pejë.

Auditimi përfshin aktivitetet e kryera nga Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore gjatë realizimit të fazës emergjente, për vitin 2015 dhe 2016.

## Çfarë kemi gjetur?

Ne kemi gjetur se aktivitetet e kryera nga Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore gjatë procesit të rishikimit të teksteve shkollore, nuk kanë arritur qëllimet e synuara. Procesi i rishikimit ka rezultuar me tekste shkollore të përmirësuara në përqindje të vogla dhe përgjithësisht të natyrës teknike. Objektiva lidhur me lehtësimin e çantës shkollore nuk është prekur fare, ndërkohë që vendimi për të botuar të gjithë tirazhin e teksteve shkollore nga klasa 1-9, përfshirë ato që nuk i janë nënshtruar rishikimit, ka krijuar shpenzime të mëdha e jo kursime siç ishte synuar fillimisht.

## Përmirësimi i pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet shkollore

Analizat tona lidhur me këtë objektive janë orientuar në tri aspekte: Procesi i rishikimit të teksteve shkollore, përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve të Këshillit dhe ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore.

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka vendosur një sistem adekuat dhe të dokumentuar mirë përmes një udhëzimi apo rregulloreje të brendshme ku do të përcaktoheshin qartë detyrat dhe përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në procesin e rishikimit të teksteve shkollore (rishikuesve që përcaktohen në faza të ndryshme kohore, ekspertëve të fushës që po ashtu përcaktohen për të mbështetur rishikimet, etj). Po ashtu, pavarësisht se ekzistonte një plan i aktiviteteve të Këshillit, përfshirë afatet kohore për realizimin e aktiviteteve, procesi i rishikimit për shkak të mos qartësisht të përgjegjësive dhe të një afati të shkurtër në dispozicion për ti realizuar ato është karakterizuar me koordinim jo të duhur midis palëve të përfshira në proces. Si rezultat, nëpërmes këtij procesi nuk u arrit që të evitoheshin mangësitë përmbajtësore të teksteve shkollore por vetëm ato teknike.
- Sugjerimet e ofruara nga mësimdhënësit kanë trajtuar ose gabime gramatikore ose ishin shumë të përgjithësuara dhe vështirë për t'u kuptuar. Pavarësisht kësaj, edhe vet autorët e teksteve përkatëse shumë pak kanë bërë analiza individuale për të shqyrtuar se çfarë përmirësimesh shtesë duhet bërë në tekstet e tyre shkollore. Edhe sipas anëtarëve të Këshillit, rezultatet e dala nga pyetësorët e plotësuar nga mësimdhënësit nuk i kishin arritur pritjet e tyre.
- Këshilli ka përcaktuar një afat kohor prej tre javësh që mësimdhënësit të ofrojnë sygjerimet e tyre për të shqyrtuar/analizuar përmbajtjen e teksteve shkollore, për t'i identifikuar mangësitë dhe për të dhënë sygjerimet e tyre për përmësim. Ky afat kohor sipas mësimdhënësve ishte i shkurtër për adresimin e nevojave reale dhe domethënëse për përmirësime në tekstet shkollore.
- Përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve për rishikimin e teksteve shkollore, veçanërisht për lëndët shkencore, nuk ishte plotësisht adekuate. Gjatë rishikimit kemi vërejtur konflikte të interesit, ku autori që ka shkruar tekstin shkollor edhe e ka rishikuar atë meqë ka qenë pjesë e anëtarëve të Këshillit.

- Mesatarja e ndryshimeve të kryera për tekstet e tri shtëpive botuese ishte 8%. Gjatë auditimit ne kemi gjetur se kishte tekste shkollore ku ishin riformuluar vetëm disa fjalë apo kishte vetëm korrigjime drejtshkrimore. Ideja fillestare ishte që gabimet e tilla të adresohen vetëm nëpërmes transmetimit të tyre nga Këshilli tek mësimdhënësit dhe nga mësimdhënësit tek nxënësit dhe jo të ribotohet i tërë teksti. Kjo alternativë nuk është marrë në konsideratë duke rezultuar me botimin e të gjithë tirazhit të teksteve shkollore.

### **Lehtësimi i çantës së shkollës**

Objektivi i dytë lidhur me lehtësimin e çantës nuk është arritur. Këshilli ka sqaruar se ata janë përqëndruar në realizimin e objektivit kryesor të tyre i cili kishte të bënte me përmirësimin e mangësive në tekstet ekzistuese shkollore.

Numri i teksteve shkollore për vitin shkollor 2016/17 nuk është zvogëluar. Ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore nuk kanë kontribuar në zvogëlimin e vëllimit të tyre. Kjo është e dukshme edhe në raportet e punës së Këshillit pasi që për përmbushjen e këtij objektivi nuk ishin paraparë hapa të qartë se si ai duhej të arrihej.

### **Kursimet buxhetore për botimin e teksteve shkollore**

Procesi i rishikimit, me gjithë mangësitë sipërfaqësore të adresuara për përmbajtjen e teksteve shkollore, ka rezultuar me ribotimin e tërë tirazhit të teksteve shkollore, me gjithsej 94 tekste shkollore. Kjo nënkupton se edhe këtë vit sikurse edhe vitin e kaluar shpenzimet buxhetore kanë krijuar kosto financiare prej 7 milion €. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit se tekstet shkollore që kanë pësuar ndryshime të pakta kanë mundur të mos ri-botohen. Alternativa e planifikuar për transmetimin e informatës nga Këshilli tek mësimdhënësit dhe nga mësimdhënësit tek nxënësit do të mundësonte që të përdroreshin librat nga viti paraprak shkollor dhe kjo do të ndikonte në shkurtimin e shpenzimeve buxhetore për botimin e teksteve shkollore.

## Çka rekomandojmë?

Rekomandojmë Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që përmes një udhëzimi administrativ apo ndonjë rregulloreje të brendshme, të:

- Definojë qartë përgjegjësitë e shtëpive botuese gjatë përgatitjes së dorëshkrimeve të teksteve shkollore;
- Obligojë secilën shtëpi botuese që të rishikojë dorëshkrimet e autorëve të teksteve nga redaktorët e vet e më pastaj ti dërgojë ato në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Për secilin dorëshkrim të emërojë recensentët dhe paraprisht të definojë qartë dhe në mënyrë të shkruar kriteret në bazë të të cilave emërohen recensentët;
- Anashkalojë mundësinë e përcaktimit si anëtar të Këshillit për Programe dhe Tekste Shkollore, autorë të teksteve shkollore, tekstet e të cilëve janë pjesë e procesit të rishikimit;
- Monitorojë në mënyrë të vazhdueshme punën e recensentëve dhe anëtarëve të Këshillit për Programe dhe Tekste Shkollore për progresin e treguar në arritjen e objektivave të synuara. Sigurohet që recensentët e emëruar dhe anëtarët e Këshillit të ofrojnë raporte të detajuara me komente dhe sugjerime për rishikimet e teksteve shkollore.

Rekomandojmë Këshillin e Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore, që:

- Të angazhojë në procesin e rishikimit ekspert të jashtëm të fushave të ndryshme të cilët janë kompetent për të kryer rishikimin e teksteve shkollore;
- Në rast të inicimit të proceseve të tjera rishikuese të teksteve shkollore të monitorojë punën e recensentëve që përcaktohen nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vlerësimin e dorëshkrimeve të teksteve të reja shkollore; - kjo është veçanërisht e rëndësishme për "fazën substanciale", që planifikohet të kryhet për vitin shkollor 2017/18;
- Të bëjë planifikim të arsyeshëm kohor për të finalizuar procese komplekse të tilla si rishikimi i teksteve shkollore;
- Të sigurojë se do të ndërmerret një analizë e duhur dhe e detajuar financiare përpara se të merret një vendim për ribotimin e tërë tirazhit të teksteve shkollore;
- Përcaktohet formula e duhur për të matur përqindjen e ndryshimeve në tekstet shkollore dhe për botim të miratohen vetëm ato tekste që kanë pësuar ndryshime thelbësore; dhe
- Të sigurohet se brenda Këshillit ka komunikim të vazhdueshëm si dhe koordinim të aktiviteteve me të gjithë pjesëmarrësit që janë pjesë e tij.

# 1 Hyrje

Teksti shkollor është themelor dhe i detyrueshëm për shkollat fillore. Ai shërben si mjet kryesor dhe një burim i dijes për një fushë të caktuar përmes të cilit arrihen qëllimet e përfshira në plan programet arsimore. Tekstet kanë për qëllim të ndihmojnë nxënësit të mësojnë. Ndërkohë, aktivitetet dhe materialet mësimore që janë të paraqitura në tekst kanë për qëllim të ndihmojnë nxënësit të fitojnë aftësi të përgjithshme dhe përvoja të përcaktuara në plan programet arsimore.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar.

Ligjit Nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në Kosovë përcakton qëllimet që ndërlidhen me përgatitjen e teksteve shkollore, nevojat që duhet të plotësohen për tekstet shkollore, procedurat e hartimit dhe botimit dhe mekanizmat e rishikimit. Teksti i duhur shkollor i cili u dorëzohet nxënësve i nënshtrohet procesi të rishikimit, i cili mund të përshkruhet si vlerësim kritik me shkrim i përmbajtjes së tekstit shkollor që është gati për t'u publikuar. Gjithashtu, ligji përcakton të drejtat dhe detyrat e secilit subjekt të përfshirë në procesin e rishikimit.

Aspektet që zakonisht merren në konsideratë në faza të ndryshme të dizajnit dhe botimit të teksteve përfshijnë specifikimet që duhet të aprovohen, vendosjen e mekanizmave, konsultimet që ndodhin dhe hulumtimet e kryera. Të gjitha këto çështje konsiderohen si thelbësore për të siguruar progres të vazhdueshëm në cilësinë e përmbajtjes së teksteve shkollore.<sup>1</sup>

Një raport<sup>2</sup> i kryer në këtë fushë gjithashtu thekson rëndësinë e rishikimit gjatë përpilimit të teksteve shkollore. Sipas këtij raporti, në mënyrë që përmbajtja të jetë në përputhje me plan-programet arsimore, është e nevojshme që t'i nënshtrohet një procesi konsultimi që përfshin disa faza, ku ftohen redaktuesit e teksteve për t'u informuar për plan-programin dhe për zhvillimet e fundit në fushën e caktuar.

Cilësia e përmbajtjes së teksteve shkollore është koncept relativ në një kohë dhe situatë të caktuar dhe nuk ekzistojnë standarde të njohura universale. Për shembull, një tekst shkollor i trajtuar si i vlefshëm në një kohë të caktuar lehtë mund të konsiderohet si i parëndësishëm disa vite më vonë. Kështu palët e përfshira në këtë çështje duhet të synojnë që të ngrisin cilësinë e dorëshkrimeve. Kjo duhet të bëhet në përputhje me plan-programet arsimore me fokus të veçantë që tekstet e propozuara të përputhen mirë me nivelin e aftësive të nxënësve dhe mësimdhënësve.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Brunswic, E. dhe Valerien, J. (UNESCO 1996), Planifikimi i zhvillimit të teksteve shkollore: një seri prej dymbëdhjetë moduleve të trajnimit për planifikuesit e arsimit dhe administratorët, Instituti Ndërkombëtar për Planifikimin Arsimor, materiale mësimore

<sup>2</sup> Byroja Arsimore (tetor 2009), Grupi Punues për libra shkollor dhe Zhvillimi i Burimeve të e-mësimit, raporti kryesor, Kapitulli 3 për Zhvillimin e Kurrikulës dhe Përpilimin e Teksteve: Situata aktuale, fq. 25

<sup>3</sup> Brunswic, E. dhe Valerien, J. (Konsulentë të INPA), Planifikimi i zhvillimit të teksteve shkollore: një seri prej dymbëdhjetë moduleve të trajnimit për planifikuesit e arsimit dhe administratorët, Instituti Ndërkombëtar për Planifikimin Arsimor, materiale mësimore, Moduli 9. Mekanizmat për përmirësime dhe kontroll të cilësisë, faqe. 319

---



## 1.1 Problemi i auditimit

Tekstet shkollore, mjetet mësimore dhe dokumentacioni pedagogjik duhet të përmbushin nevojat arsimore, shkencore, pedagogjike, psikologjike, didaktiko-metodike, etike, gjuhësore, artistike dhe teknike në përputhje me standardet dhe objektivat e planeve dhe programeve mësimore. Përveç kësaj, tekstet shkollore dhe çdo burim i sipër përmendur apo dokument nuk lejohen për botim në rast se shkel të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore apo që nxit urrejtje politike, kombëtare dhe fetare.<sup>4</sup>

Vlerësimi kritik i teksteve shkollore është i rëndësishëm me qëllim që të sigurohet se tekstet i përmbushin nevojat arsimore dhe në to nuk prezantohen shkelje ndaj ndonjë grupi të veçantë në shoqëri.

Ekzistojnë disa çështje që i kemi identifikuar nga burime të ndryshme dhe që japin indikacione se në përmbajtjen e teksteve aktuale shkollore ka vend për përmirësime.

Në këtë kontekst ekzistojnë hulumtime, raporte nga organizata joqeveritare dhe shkrime në media të cilat kanë theksuar mangësi në përmbajtjen e teksteve shkollore, si:<sup>5</sup>

- Prania e gabimeve shkencore,
- Mbingarkesa me përmbajtje të parëndësishme dhe të panevojshme,
- Mos stimulimi i mendimit kritik në mesin e nxënësve nga tekstet e tilla, dhe
- Mungesa e stimulimit të mësimdhënësve në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies për të prezantuar materialin në tekst.

Burime të tjera theksojnë se në tekstet e shkollave fillore ka mangësi që ndërlihen me diskriminim gjinor.<sup>6</sup> Poashtu, ekspert të lëndës kanë identifikuar gabime në tekstet e fizikës që kryesisht ndërlihen me përmbajtjen e tekstit, por edhe me gabime të tjera gjuhësore, teknike dhe pedagogjike.<sup>7</sup> Përveç aspektit të cilësisë së përmbajtjes së teksteve shkollore shqetësim më vete paraqet edhe pesha e rëndë e çantave të shkollës.<sup>8</sup> Gjithashtu, shpenzimet e larta për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, të cilat e tejkalojnë buxhetin e planifikuar për këtë qëllim, janë trajtuar në raportet e mëhershme të rregullsisë për MASHT dhe në raportin e performancës<sup>9</sup> të lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

---

<sup>4</sup> Ligji Nr. 02 / L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, neni 3, Pikët 3.1 dhe 3.2

<sup>5</sup> BIRN (janar 2013), Probleme dhe Dobësi në tekste shkollore (Analizë e teksteve shkollore në Kosovë për klasat VI, VII, VIII dhe IX), Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Prishtinë

<sup>6</sup> Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2007), Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor, Prishtinë

<sup>7</sup> Ardian B. Gojani (13 maj 2015), Rishikimi kritik i teksteve të fizikës, Konferenca e MASHT, Java Shkencore, Prishtinë

<sup>8</sup> Njëri ndër artikujt e shumtë që referon këtë çështje është: <http://lajmi.net/cantat-e-mbi-ngarkuara-te-nxenesve-shqetesim-per-prinderit/>

<sup>9</sup> Raporti: Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, Zyra Kombëtare e Auditimit, 2015. Si tregues për të motivuar këtë auditim përpos tjerash kanë shërbyer edhe raportet e mëhershme të rregullsisë të kryera nga ZKA, shih: nënkaptulli 1.1, f.3

---

Si rezultat, bazuar në burimet e përmendura më lart, ne arrijmë tek problemi i auditimit se:

**“Aktivitetet e ndërmarra gjatë procesit të rishikimit për të përmirësuar tekstet shkollore nuk kanë arritur qëllimet e synuara.”**

## 1.2 Objektivi dhe pyetjet e auditimit

Objektiv kryesor i këtij auditimi është vlerësimi i aktiviteteve të ndërmarra nga MASHT, respektivisht Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore (KEPTSH) në arritjen e qëllimeve të synuara në procesin e rishikimit të teksteve shkollore.

Për t’iu përgjigjur objektivit të auditimit, ne kemi parashtruar pyetjen e auditimit si në vijim:

- 1. A po arrin procesi i rishikimit i inicuar nga MASHT qëllimet e synuara për përmirësim të teksteve shkollore?*

*Sa është arritur që nëpërmes procesit të rishikimit të teksteve shkollore të:*

- 1.1 Arrihen përmirësime të pasaktësive ekzistuese në përmbajtjen e teksteve shkollore?*
- 1.2 Arrihet lehtësimi i peshës së çantës shkollore?*
- 1.3 Arrihet kursim buxhetor për qëllime të botimit të teksteve shkollore?*

## 1.3 Kriteret e auditimit

Kriteret e auditimit të përdorura në këtë auditim rrjedhin nga standardet ndërkombëtare, praktikat e mira dhe legjislacioni kombëtar. Po ashtu, disa nga kriteret e testuara janë në pajtueshmëri edhe me entitetin nën auditim që në këtë rast është MASHT.

- Shtëpitë botuese dhe autorët, gjatë përpilimit të teksteve shkollore, duhet të marrin në konsideratë që tekstet shkollore të jenë jo vetëm një mbështetje për mësimdhënie, por edhe mjete të rëndësishme të edukimit moral që zhvillojnë qëndrimet sociale të nxënësve. Gjithashtu, secili kapitull dhe mësim në tekstet shkollore duhet të pasohet me disa pyetje dhe një listë të veprimtarive apo punës praktike me qëllim të kontrollimit dhe kuptimit të çështjes që është mësuar si dhe për të ndihmuar trajnimin e mendjes së nxënësit dhe zhvillimin e aftësive të tij/saj.<sup>10</sup>
- Të gjitha subjektet e përfshira drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi në përpilimin e teksteve shkollore duhet të krijojnë mekanizma për rishikimin e tyre për të siguruar që shkollat kanë në dispozicion tekste me përmbajtje cilësore. Mekanizmat e rishikimit mund të rregullohen në forma të ndryshme dhe zakonisht varen nga konteksti i vendit i cili i miraton ato. Mekanizmat që zakonisht përdoren përfshijnë:

---

<sup>10</sup> Brunswic, E. dhe Valerien, J. (Konsulentë të INPA), Planifikimi i zhvillimit të teksteve shkollore: një seri prej dymbëdhjetë moduleve të trajnimit për planifikuesit e arsimit dhe administratorët, Instituti Ndërkombëtar për Planifikimin Arsimit, materiale mësimore, Moduli 9. Mekanizmat për përmirësime dhe kontroll të cilësisë

- *Masat që kanë për qëllim trajnimin e ekipeve redaktuese (autorët brenda shtëpive botuese që zhvillojnë tekstet shkollore dhe redaktorët brenda shtëpive botuese që synojnë rishikimin e dorëshkrimeve të shkruara nga autorë të teksteve);*
  - *Krijimin e një komisioni të specializuar - Përbërja dhe autoriteti i të cilit në shumicën e rasteve përcaktohen me rregullore;*
  - *Themelimi i një paneli ekspertësh të monitorimit - detyrë e të cilit do të ishte të monitorojë punën e vetë recensentëve.<sup>11</sup>*
- Subjekti përgjegjës për organizimin e procesit të rishikimit për përpilimin e teksteve shkollore duhet të vendosë kritere të qarta për emërimin e recensentëve dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Gjithashtu subjekti përgjegjës duhet të vendos kritere të qarta të cilat do të mbështesin recensentët në vlerësimin e dorëshkrimeve të teksteve shkollore.<sup>12</sup>
- Subjekti përgjegjës gjithashtu duhet të ketë komunikim/konsultim adekuat dhe të vazhdueshëm me pjesëmarrësit tjerë që janë të rëndësishëm për procesin, si ekspertë të fushës, menaxhmentin e shkollës, mësimdhënësit.<sup>13</sup>

Poashtu:<sup>14</sup>

- Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë pesha e çantës të cilën e bart nxënësi në shkollë duhet të peshojë vetëm 10% të peshës trupore të fëmijut; dhe
- Entiteti që kryen procesin e rishikimit duhet që gjatë procesit rishikues të shqyrtojë alternativa të ndryshme që do të rezultojnë në kursime buxhetore. Alternativat do të ishin relevante sidomos për rastet kur tekstet shkollore që i nënshtrohen rishikimit nuk kanë nevojë për ndryshime të mëdha.

## 1.4 Fushëveprimi i auditimit

Subjekti kyç i auditimit është MASHT. Fushëveprimi ynë i auditimit në kuadër të MASHT fokusohet në punën e KEPTSH dhe fazën emergjente (me informata shtesë edhe nga faza substanciale). Ne kemi zgjedhur edhe tri komuna dhe shkolla në secilën komunë për të kuptuar se si ato janë përfshirë në këtë proces. Komunitat e përzgjedhura janë: Prishtina, Gjilani dhe Peja. Në Prishtinë kemi vizituar dy shkolla, ndërsa në Gjilan dhe Pejë kemi vizituar një shkollë. Brenda secilës komunë i kemi vizituar edhe Drejtoritë përkatëse të arsimit.

Auditimi përfshin aktivitetet e kryera nga KEPTSH për fazën emergjente gjatë vitit 2015 dhe 2016.

---

<sup>11</sup> Byroja Arsimore (tetor 2009), Grupi Punues për libra shkollor dhe Zhvillimi i Burimeve të e-mësimit, raporti kryesor, Kapitulli. 3 për Zhvillimin e Kurrikulës dhe Përpilimin e Teksteve: Situata aktuale, fq. 25

<sup>12</sup>Ligji Nr. 02 / L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, neni 7, pika 7.4

<sup>13</sup> Kriteri i vendosur sipas gjykimit profesional i auditorëve siç parashihet me Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

<sup>14</sup>Këto dy kritere ndërlidhen me objektivat që KEPSHT i ka paraparë për t'i arritur nëpërmes procesit të rishikimit të përmbajtjes së teksteve shkollore.

---

## 1.5 Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit ekipi auditues ka kryer disa aktivitete, si:

- Analiza e legjislacionit në lidhje me rishikimin dhe botimin e teksteve shkollore;
- Shqyrtimi i praktikave të mira ndërkombëtare;
- Intervistat me tre drejtorë komunal të arsimit;
- Intervistat me tre drejtorë të shkollave dhe një zëvendës drejtor të shkollës; intervista me tre mësues në secilën nga shkollat e përzgjedhura (ata që janë përfshirë në rishikimet e teksteve shkollore);
- Shqyrtimi i pyetësorëve të plotësuar nga mësuesit e shkollës.
- Dy intervista me Ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të MASHT dhe dy intervista me zëvendësministren brenda MASHT në cilësinë e udhëheqësit të KEPTSH;
- Pjesëmarrja në një takim të KEPTSH dhe intervista me tre anëtarë të KEPTSH;
- Shqyrtimi i dy dorëshkrimeve për dy lëndë të ndryshme që kanë kaluar nëpër proces të rishikimit dhe kemi krahasuar ato dhe ndryshimet e tyre me versionet origjinale të teksteve shkollore;
- Analizimi i procesverbaleve të mbledhjeve të KEPTSH, raporteve të tyre dhe korrespondencës me anëtarët e tyre dhe shtëpitë botuese;
- Analizimi i raporteve të prezantuara nga shtëpitë botuese të MASHT lidhur me zhvillimin e procesit të rishikimit dhe ndryshimet e bëra në tekste shkollore të klasave 1-9 si rezultat i këtij procesi;
- Analizimi i raporteve të secilit grup punues brenda KEPTSH në lidhje me zhvillimin e procesit dhe ndryshimet që duhet të bëhen për subjektet e teksteve shkollore për të cilat janë caktuar të japin komente.

## 2 Subjektet kyçe dhe përgjegjësitë e tyre

Tekstet ekzistuese shkollore janë rezultat i ofertës së shpallur nga MASHT në vitin 2001/02 për botimin e teksteve shkollore, ofertë kjo e cila ka zgjatur deri në vitin 2008.

Ligji nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2006, dhe për ne nuk është e njohur se si është rregulluar procesi i botimit të teksteve shkollore gjatë kohës kur fillimisht është shpallur oferta më 2001/02. Edhe pse në këtë ligj (i cili aktualisht është në rishikim e sipër) ndër të tjera përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e shtëpive botuese dhe kriteret në bazë të të cilave recensentët vlerësojnë dorëshkrimet e paraqitura nga shtëpitë botuese, askund nuk theksohet mbi çfarë kriteresh duhet emëruar recensentët nga MASHT. I njëjti ligj gjithashtu i referohet një udhëzimi administrativ për vlerësimin e dorëshkrimeve në bazë të të cilit recensentët duhet të punojnë, por nuk ekziston asnjë dëshmi se ky udhëzim është krijuar ndonjëherë.

Që nga viti shkollor 2008/09, MASHT ka furnizuar nxënësit prej klasës 1-5 me tekste shkollore falas, ndërsa nga viti 2009/10 e tutje e njëjta praktikë është aplikuar për nxënësit e klasës 1-9.

Më poshtë kemi prezantuar subjektet kyçe të përfshira në procesin e rishikimit si dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre në raport me rishikimin e teksteve shkollore.

### 2.1 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MASHT është subjekti kryesor përgjegjës për vendosjen e mekanizmave të cilat shërbejnë për kryerjen e rishikimit të teksteve shkollore.

MASHT është përgjegjës për shpalljen e konkursit publik për botimin e teksteve dhe e bën këtë në bazë të planeve dhe programeve mësimore. Kur ndodh rasti që oferta e parë e shpallur të dështojë, është përgjegjësi e po të njëjtit që të vazhdojë me ri-tenderim. Në rast se oferta rezulton e suksesshme dhe secila shtëpi botuese të ketë dorëzuar dorëshkrimet e tyre, është roli i MASHT të emërojë recensentët të cilët do të vlerësojnë dorëshkrimet e dorëzuara.

MASHT është përgjegjës për botimin dhe shpërndarjen e katalogut të teksteve shkollore në të cilën përfshihet: lloji i shkollës, klasa, emrat e autorëve, titujt, lënda dhe klasa e aprovuar, botuesi dhe çmimi i shitjes.

KEPTSH në kuadër të MASHT kanë të drejtë të mbikëqyrin procedurën e përpilimit dhe botimit të teksteve shkollore.

MASHT ka për obligim të emërojë të paktën tre ekspertë të fushave përkatëse si recensent. Në rast se recensentët nuk paraqesin vlerësimin e tyre me shkrim në kohën e caktuar (e cila është brenda 30 ditëve), MASHT duhet të zëvendësojë ata me anëtarë të tjerë.

## 2.2 Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore

Ky këshill është themeluar në korrik të vitit 2015 me vendim të Ministrit të MASHT. Ministri ka themeluar KEPTSH në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore, dispozitat e Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe dispozitat e Ligjit nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Detyrat dhe përgjegjësitë e KEPTSH përfshijnë:

- Planifikimin e procesit të përgatitjes së teksteve të reja shkollore bazuar në plan-programet mësimore për klasë dhe lëndë të caktuara;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve për tekste shkollore nga autorët e teksteve dhe shtëpitë botuese;
- Autorizimin e grupeve punuese për rishikimin e teksteve aktuale shkollore, duke i krahasuar me standardet për tekstet shkollore;
- Mbështetjen e planit/programit të trajnimeve për autorët e teksteve shkollore dhe shtëpive botuese;
- Themelimin e ekipeve të rishikuesve për lëndë e fusha të caktuara të plan-programeve mësimore, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e raporteve të tyre;
- Krijimin e mekanizmave për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat apo komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore, për identifikimin e mangësive eventuale të teksteve dhe nevojën e tyre për përmirësim;
- Shqyrtimin dhe aprovimin e raporteve nga shtëpitë botuese për t'u siguruar se tekstet janë përmirësuar sipas kërkesave dhe propozimeve të dëshmuara me fakte nga shkollat.

KEPTSH gjithashtu raporton për punën e vet tek Ministri i MASHT në baza periodike dhe sipas kërkesës. Ai përbëhet nga 19 anëtarë që vijnë nga fusha të ndryshme të ekspertizës. Shumica e anëtarëve të KEPTSH janë zyrtarë brenda MASHT. Këshilli udhëhiqet nga zëvendësministri i MASHT, dy anëtarë janë nga kabineti i ministrit, dhe pjesa tjetër e anëtarëve vijnë nga Divizioni për Plan-programe dhe tekste shkollore të cilët i ofrojnë KEPTSH mbështetje teknike dhe operative. Tre anëtarë të KEPTSH janë autorëve të teksteve, dhe pjesa tjetër vijnë ose nga shoqëria civile ose janë ekspertë të fushave të caktuara.

## 2.3 Recensentët

Recensentët, të cilët emërohen nga MASHT, janë përgjegjës për të bërë një vlerësim kritik me shkrim të teksteve shkollore para botimit.

Është roli i shtëpive botuese të paraqesin dorëshkrimet anonime të teksteve shkollore tek MASHT, derisa recensentët i marrin këto dorëshkrime në kode në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe ata të jenë të paanshëm.

Recensentët janë të pavarur në punën e tyre dhe kjo është përgjegjësi e secilit prej tyre për të vlerësuar dorëshkrimet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Përputhjen e përmbajtjes me qëllimet, objektivat dhe me standardet e planit dhe të programit mësimor;
- Zbatimin e metodologjive të reja të mësimdhënies dhe mësim nxënies;
- Shoqërimin e përmbajtjes dhe të ilustrimeve me aparaturë të përshtatshme didaktike;
- Ofrimin e materialeve për punë të pavarur dhe kreative; dhe
- Përshtatjen e gjuhës së tekstit me moshën e nxënësve për të cilët është shkruar teksti shkollor.

Është obligim i çdo recensuesi të paraqesin vlerësimin e tyre me shkrim dhe me argumente se pse një dorëshkrim vlerësohet pozitivisht ose jo pozitivisht.

## 2.4 Mësimdhënësit

Tekstet shkollore përgatiten për të ndihmuar nxënësit gjatë mësimit dhe mësimdhënësit janë akterë kyç në këtë proces meqë i shfrytëzojnë tekstet shkollore dhe tek nxënësit transferojnë njohuritë dhe informacionet e dhëna në to.

Mësimdhënësit kanë të drejtën dhe obligimin e përdorimit të teksteve shkollore në përputhje me katalogun e teksteve shkollore të publikuar dhe shpërndarë nga MASHT. Ndërkohë, çdo mësimdhënës ka të drejtë të përdor literaturë shtesë në rast se konsiderohet se është e nevojshme. Është përgjegjësi e mësimdhënësit të sigurojë që literatura shtesë e shfrytëzuar konsiston me plan-programin e lëndës.



## 3 Të gjeturat

Inicimi i një procesi të rishikimit të teksteve shkollore është një iniciativë që është ndërmarrë nga MASHT për herë të parë pas më shumë se dymbëdhjetë vitesh.<sup>15</sup>

KEPTSH përmirësimin e teksteve shkollore ka synuar ta arrijë duke e ndarë procesin e punës në dy faza, të njohura si: faza emergjente dhe faza substanciale.

Në fazën emergjente është vendosur për tekstet shkollore që do të ri-botohen si rezultat i rishikimeve për vitin shkollor 2016/17. Ndërkaq, faza substanciale ka për qëllim iniciimin e një cikli të ri të përpilimit të teksteve shkollore, në pajtueshmëri dhe sipas kërkesave të kurrikulës së re dhe pritet të implementohet për vitin shkollor 2017/2018.

Fokusi ynë në këtë auditim janë aktivitetet e KEPTSH me fazë emergjente.

KEPTSH në raportin e vet ka theksuar se përmes aktiviteteve të ushtruara në fazën emergjente synonte të arrinte tri objektiva, të cilat janë:

- Përmirësimi i pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet shkollore;
- Lehtësimi i çantës së shkollës; dhe
- Kursimi buxhetor për botimin e teksteve shkollore.

Ne kemi vlerësuar nëse këto objektiva janë arritur. Më poshtë prezantojmë rezultatet e auditimit, respektivisht të gjeturat.

### 3.1 Përmirësimi i pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet ekzistuese shkollore

#### 3.1.1 Procesi i rishikimit

Procesi i rishikimit të teksteve shkollore nuk është i qartë dhe i dokumentuar mirë. MASHT nuk ka vendosur një sistem adekuat dhe të dokumentuar mirë përmes një udhëzimi apo rregulloreje të brendshme ku do të përcaktoheshin qartë detyrat dhe përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në procesin e rishikimit të teksteve shkollore (rishikuesve që përcaktohen në faza të ndryshme kohore, ekspertëve të fushës që po ashtu përcaktohen për të mbështetur rishikimet, etj). Po ashtu, pavarësisht se ekzistonte një plan i aktiviteteve të Këshillit, përfshirë afatet kohore për realizimin e aktiviteteve, procesi aktual i rishikimit për shkak të mos qartësisht të përgjegjësive dhe të një afati të shkurtër në dispozicion për ti realizuar ato është karakterizuar me koordinim jo të duhur midis palëve të përfshira në proces. Si rezultat, nëpërmes këtij procesi nuk u arrit që të evitoheshin mangësitë përmbajtësore të teksteve shkollore por vetëm ato teknike.

---


<sup>15</sup>Raporti i punës së Këshillit të Ekspertëve për Programet dhe Tekstet Shkollore dërguar ministrit të MASHT-it, 03.05.2016

---



Ndryshimet e bëra në tekstet shkollore siq u tha më lartë kanë qenë më shumë të natyrës teknike se sa përmbajtësore. Poashtu, afatet kohore për adresimin e nevojave për ndryshime në tekste kanë qenë shumë të shkurtra. Janë organizuar grupe të mësimdhënësve nëpër shkolla për të rishikuar tekstet shkollore mirëpo pas analizimit që i kemi bërë formularëve të plotësuar nga mësimdhënësit kemi vërejtur se sugjerimet për ndryshime kanë qenë tejet sipërfaqësore për të mos thënë në raste të caktuara nuk janë dhënë fare komente. Poashtu, sipas anëtarëve të KEPSHT rezultatet e dala nga pyetësorët nuk i kishin arritur pritjet e tyre.

Diagrami i mëposhtëm paraqet fazat në proces si dhe palët përgjegjëse. Po ashtu në mënyrë narrative kemi bërë përshkrimin e gjendjes lidhur me përmirësimet e bëra në tekste shkollore.



KEPSHT ka vendosur që mënyra më e mirë për të përmirësuar pasaktësitë shkencore dhe gabimet teknike në tekstet shkollore ishte që fillimisht në këtë proces të përfshijë mësimdhënësit e shkollave për të dhënë sugjerimet e tyre për ndryshimet eventuale që mund të bëhen. KEPSHT e ka bërë këtë duke dërguar formularë të standardizuar në 8 shkolla në 7 komuna. Mësimdhënësit në kuadër të secilës shkollë të përzgjedhur duhej të plotësonin formularët duke identifikuar së pari gabimet teknike dhe shkencore në lëndët për të cilat janë kompetent. Pastaj në formularë është kërkuar që për secilin gabim të identifikuar të propozojnë sugjerimet e tyre se si duhet përmirësuar ato.

Mësimdhënësit e shkollave kishin tri javë në dispozicion për të plotësuar këta formularë dhe ti dorëzuan ato në KEPSHT. Gjatë auditimit tonë në tri komunat e përzgjedhura ne u informuam nga shumica e mësimdhënësve të intervistuar se koha e lejuar nga KEPSHT për të plotësuar formularët ishte e shkurtër marrë parasysh sasinë dhe vëllimin e teksteve shkollore që duheshin shqyrtuar. Është thelbësore që të theksohet se formularët e dorëzuar nga shkolla tek KEPSHT nuk ishin plotësuar për të gjitha lëndët nga klasa 1 deri 9. Pra, kishte tekste shkollore të lëndëve të caktuara për të cilat nuk janë dhënë fare sugjerime pasi që nuk kanë qenë të përfshira në rishikim.

Anëtarët e KEPSHT kanë shqyrtuar rezultatet e këtyre formularëve nga të cilët kryesisht u identifikuan gabime të natyrës teknike dhe shumë pak sugjerime identifikuan gabime substanciale.

Anëtarët e KEPTSH ishin të ndarë në katër grupe punuese për të shqyrtuar formularët. Grupet punuese ishin si më poshtë:

- Grupi punues për gjuhë dhe letërsi shqipe,
- Grupi punues për Shkenca Sociale (Histori, Gjeografi, Edukatë Qytetare),
- Grupi punues për Matematikë, Bazat e Arsimit Teknik, Teknologji Informative), dhe
- Grupi punues për lëndët shkencore (Fizikë, Kimi, Biologji, Njeriu dhe Natyra).

Secili grup punues përbëhej nga katër anëtarë mesatarisht. Grupet punuese të KEPTSH nuk kanë rishikuar secilin tekst shkollor në tërësi për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale, por ata janë bazuar vetëm në formularët e ofruar nga shkolla. Shumica e anëtarëve të grupeve punuese kanë theksuar mungesën e emrave të recensentëve në shumë tekste shkollore.

KEPTSH më pas ka dërguar formularët tek shtëpitë botuese nga të cilat edhe është kërkuar të hartojnë një katalog i cili do të tregonte se cilat sugjerime të propozuara nga shkollat janë marrë në konsideratë dhe janë integruar në tekste shkollore. KEPTSH gjithashtu ka kërkuar nga shtëpitë botuese të punojnë ngushtë me autorët e teksteve për të bërë një rishikim të plotë të teksteve për të identifikuar përmirësime të tjera, pra të plotësohen ato aspekte që mund të mos jenë adresuar nga formularët e shkollave.

Shtëpitë botuese më pas i kanë dërguar anëtarëve të KEPTSH një prototip të secilit tekst shkollor që ishte pjesë e rishikimit të tyre. Lidhur me këtë anëtarët e KEPTSH kanë shqyrtuar ndryshimet e bëra nga shtëpitë botuese dhe kanë ekzaminuar nëse përmirësimet e kërkuara janë marrë parasysh. Grupet punuese në kuadër të KEPTSH kanë arritur në përfundim se shtëpitë botuese edhe autorët e teksteve shkollore nuk kanë marrë parasysh shumë nga përmirësimet e kërkuara. Për këtë arsye, grupet punuese kanë hartuar raportet e tyre të punës dhe kanë kërkuar nga shtëpitë botuese ti bëjnë përmirësimet e tjera.<sup>16</sup>

Ka pasur raste kur grupet punuese të KEPTSH gjatë rishikimit të teksteve shkollore i janë referuar vetëm prototipit të ofruar nga shtëpia botuese me përmirësimet e bëra. Megjithatë, shtëpia botuese nuk ka ofruar edhe versionin origjinal të tekstit shkollor në mënyrë që grupi punues të mund të krahasojë atë me prototipin dhe të konfirmojë nëse ndryshimet janë bërë. Kjo çështje ishte evidente sidomos me grupin punues në “Gjuhë dhe letërsi shqipe”, të cilët e kishin të vështirë të analizojnë prototipin e dhënë pasi që shtëpia botuese “Libri shkollor” nuk iu kishte ofruar atyre versionin origjinal të tekstit shkollor.<sup>17</sup>

Në raundin e dytë të rishikimeve, shtëpitë botuese i kanë dërguar raportet e tyre në KEPTSH përfshirë edhe raportet individuale të autorëve të teksteve duke i theksuar:

- sugjerimet që ata janë të gatshëm ti marrin parasysh në tekstet e tyre;
- sugjerimet që nuk do të merren parasysh; dhe

---

<sup>16</sup> Raporti i punës së Këshillit të Ekspertëve për Programet dhe Tekstet Shkollore (29.04.2016)

<sup>17</sup> Raporti i grupit të punës për vlerësimin e teksteve shkollore të lëndës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (6 prill, 2016), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, KEPTSH, Prishtinë

---

- në disa raste edhe sugjerimet shitesë të propozuara nga ana e tyre.

Në raportet e paraqitura nga autorët e teksteve theksohet se sugjerimet e ofruara nga mësimdhënësit kanë trajtuar ose gabime gramatikore ose ishin shumë të përgjithësuara dhe vështirë për t'u kuptuar. Pavarësisht kësaj, ne kemi gjetur se edhe vet autorët e teksteve shumë pak kanë bërë analiza individuale për të shqyrtuar se çfarë përmirësimesh shitesë duhet bërë në tekstet e tyre shkollorë.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se nga intervista e mbajtur me Udhëheqësen e KEPTSH ne kuptuam se sipas vlerësimit të saj koha për të përfunduar procesin e rishikimit ishte e kufizuar.

### 3.1.2 Përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve të KEPTSH

Përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve për rishikimin e teksteve shkollorë, veçanërisht për lëndët shkencore, nuk ishte plotësisht adekuate. Gjatë rishikimit kemi vërejtur konflikte të interesit që nënkupton se autori i cili ka shkruar tekstin shkollor edhe e ka rishikuar atë.

Ne kemi vërejtur disa mangësi në përbërjen e grupeve punuese të KEPTSH. Të katër anëtarët brenda secilit grup punues është dashur të rishikojnë një grup të veçantë të lëndëve. Mangësitë ishin të dukshme në mënyrë të veçantë brenda grupit punues i cili ka rishikuar lëndët shkencore. Dy nga anëtarët ishin përgjegjës dhe të kualifikuar për të rishikuar tekstet e fizikës, ndërsa dy anëtarët tjerë kishin kualifikime në kimi dhe psikologji.

Gjatë auditimit ne kemi gjetur se njëri nga anëtarët me kualifikim në fushën e kimisë nuk ka marrë pjesë në shumicën e takimeve të grupit për rishikimin e teksteve shkollorë të po kësaj lënde. Si rezultat, ndryshimet që janë bërë në tekstet e kimisë dhe biologjisë janë varur vetëm nga sugjerime teknike të ofruara nga mësimdhënësit.

Grupi punues për lëndët shkencore ka kërkuar krijimin e një grupi punues me anëtarë që janë njohës të fushës së biologjisë dhe kimisë, megjithatë një grup i tillë nuk është themeluar.<sup>18</sup>

Tre anëtarë në KEPTSH janë edhe autorë të teksteve shkollorë të cilat shfrytëzohen nga shkollat. Kemi raste kur anëtari i grupit të lëndëve shkencore, respektivisht fizikës, ka qenë i përfshirë në rishikimin e teksteve të fizikës dhe një gjë e tillë është konsideruar si jo etike nga shtëpitë botuese. Sipas tyre, do të kishte qenë më mirë nëse MASHT nuk do të kishte përfshirë si anëtarë të KEPTSH një autor të teksteve shkollorë, teksti i të cilit është pjesë e rishikimit, për të shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.<sup>19</sup>

---

<sup>18</sup> Procesverbal (6 prill, 2016), grupi punues për lëndët shkencore

<sup>19</sup> Shtëpia botuese "Dukagjini" (19 prill, 2016), Raporti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zhvillimin e fazës së dytë të rishikimit të teksteve shkollorë (1-9)

---

### 3.1.3 Ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore


Në këtë pjesë kemi shqyrtuar raportet përfundimtare të shtëpive botuese ku ato kanë listuar tekstet që janë rishikuar nga KEPTSH dhe përqindjen e ndryshimeve të bëra për secilin prej tyre.

Nga tabela e mëposhtme shihet se mesatarja e ndryshimeve të kryera për tekstet e tri shtëpive botuese është rreth 8%. Gjatë auditimit ne kemi gjetur se në tekstet shkollore kishte raste kur ishin riformuluar vetëm disa fjalë apo kishte vetëm korrigjime drejtshkrimore. Fillimisht nga KEPTSH është planifikuar që në rastin kur teksti shkollor ka pësuar ndryshim shumë të vogël dhe të natyrës teknike, gabimet e atij teksti të adresohen vetëm nga mësimmshënësit gjatë zhvillimit të orës klasore për lëndën e caktuar.

Tabela 1: Ndryshimet e bëra në tekstet shkollore (klasa 1-9)<sup>20</sup>

Shtëpia botuese	Numri i teksteve shkollore me ndryshimet e bëra	Mesatarja e ndryshimeve (e shprehur në%)
Libri Shkollor	23	13.2
Dukagjini	32	11
Albas	1	1
<b>Mesatarja e ndryshimeve për tri shtëpitë botuese</b>	56	8.4

Sipas analizave të bëra ne kemi vërejtur se përqindja e ndryshimeve dallon nga një tekst në tjetrin (Shih Anekset 1, 2 dhe 3 për përqindjet e secilës shtëpi botuese të paraqitura për secilin tekst shkollor që i është nënshtruar rishikimit). Ne kemi gjetur se ka tekste me ndryshime më pak se 8% dhe të tjerat me ndryshime mbi 8%. Për të ilustruar këtë, ne kemi paraqitur grafikun e mëposhtëm.



<sup>20</sup> Gjatë kësaj analize ne nuk kemi marrë parasysh ndryshimet e bëra në librat e punës dhe fletoret tjera të punës të cilat i plotësojnë tekstet themelore.

Siç shihet nga grafiku, ka tekste të cilat kanë ndryshime shumë të vogla. Në katër rastet e paraqitura në grafik ndryshimet ishin edhe më të vogla se 5%. Shumica e teksteve që do të ribotohen kishin përqindje të ulët të ndryshimeve, kryesisht jo më shumë se 10%. Nga ana tjetër, nga grafiku (dhe nga Aneksët 1,2 dhe 3 të këtij raporti) vërehet se tekstet që kanë pësuar ndryshime me përqindje të lartë ishin të pakta. Tekstet e përfshira në grafik karakterizohen në masë të madhe me ndryshime të natyrës teknike. Në sugjerimet që kanë identifikuar mësime të mësimdhënësve përmes formularëve të tyre për ndryshimet që duhen bërë, në shumë pak raste ata kanë dhënë alternativa për përmirësim të përmbajtjes së tekstit ekzistues.

Në listat e ofruara nga shtëpitë botuese tek KEPTSH ka kolona që tregojnë përqindjen e ndryshimit të teksteve shkollorë në rishikimin e parë dhe të dytë veç e veç. Gjatë rishikimit të listave të ofruara nga shtëpitë botuese kemi vërejtur se në shumë pak raste ka pasur ndryshime shtesë të bëra gjatë rishikimit të dytë, e që do të thotë se procesi ka vazhduar vetëm me ndryshimet nga rishikimi i parë.

Në listën e teksteve shkollorë të ofruara nga shtëpia botuese “Dukagjini”, nga 32 tekste shkollorë vetëm 7 tekste kishin ndryshime shtesë pas rishikimit të dytë, të cilat edhe ashtu ishin shumë të vogla dhe teknike. Nga ana tjetër, në listën e teksteve shkollorë të ofruara nga shtëpia botuese “Libri shkollor”, 11 nga 23 tekste shkollorë kanë pësuar ndryshime pas rishikimit të dytë. Ngjashëm me rastin e mëparshëm me shtëpinë botuese “Dukagjini” në shumicën e rasteve përmirësimet e bëra pas rishikimit të dytë ishin të vogla dhe teknike.

#### Foto 1: Vëzhgimet e prototipave dhe origjinaleve të dy teksteve shkollorë



Gjatë kryerjes së këtij auditimi ne kemi verifikuar ndryshimet e bëra në tekste shkollorë. Ne, për qëllime krahasimi, kemi kërkuar nga KEPTSH dy tekste origjinale (Gjuha Shqipe për nxënësit e klasës së 8 dhe Edukata Qytetare për nxënësit e klasës së 7) dhe prototipat e tyre me ndryshime, sikurse i kemi paraqitur në foton më lartë.

Pasi kemi krahasuar origjinalin me prototipin kemi verifikuar se ndryshimet e bëra janë ato që janë të listuara edhe në listën përfundimtare të shtëpive botuese. Tek teksti shkollor “Gjuha Shqipe 8” ekzistojnë katër njësi mësimore që janë larguar nga teksti, ndërsa katër përmirësime të tjera të



bëra në katër faqe tekstit janë gabime drejtshkrimore dhe gramatikore. Megjithatë, është e diskutueshme nëse ndryshime të tilla si ato të bëra në këtë tekst janë të mjaftueshme për të përmirësuar përmbajtjen e tekstit dhe miratimin për ribotim. Nga ana tjetër, teksti “Edukatë Qytetare 7” është i vetmi tekst që është përmirësuar me 37.2%. Pasi kemi verifikuar originalin dhe prototipin, kemi gjetur se teksti ka përgjithësisht përmirësime të natyrës teknike, mirëpo nuk mungojnë edhe përmirësimet përmbajtësore.

Tekstet shkollore që nuk janë përfshirë në listat e rishikimit tek shtëpitë botuese “Dukagjini” dhe “Libri Shkollor” janë 38 tekste, nga lënda e muzikës, vizatimit, gjuhës angleze dhe edukatës fizike. Këto tekste janë ribotuar pavarësisht faktit që nuk i janë nënshtruar rishikimit. Së bashku me tekstet që i janë nënshtruar rishikimit numri i teksteve që janë ribotuar është 94.

## 3.2 Lehtësimi i çantës së shkollës

Në këtë aspekt, kemi gjetur se objektivi i dytë i fazës emergjente e cila kishte për qëllim të lehtësoj çantën e shkollës nuk është arritur. Në vend të kësaj, anëtarët e Këshillit janë përqendruar në realizimin e objektivit kryesor të tyre i cili është përmirësimi i mangësive në tekstet ekzistuese shkollore.

Numri i teksteve shkollore për vitin shkollor 2016/17 nuk është zvogëluar. Ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore nuk kanë kontribuar në zvogëlimin e vëllimit të tyre. Kjo është e dukshme edhe në raportet e punës së Këshillit pasi që për përmbushjen e këtij objektivi nuk ishin paraparë hapa të qartë se si ai duhej të arrihej.

## 3.3 Kursimet buxhetore për botimin e teksteve shkollore

KEPTSH në raportet e veta thekson se arritja e kursimeve buxhetore për botimin e teksteve shkollore ishte një nga tri objektivat e saj në kuadër të fazës emergjente.

Në vitin 2016 u ribotuan rreth 94 tekste shkollore nga shtëpitë botuese, që nënkupton gjithë katalogun e teksteve shkollore të ofruara nga shtëpitë botuese. Këto tekste shkollore vlejné vetëm për vitin shkollor 2016/17 për klasat 1 deri 9.

Ne kemi vërejtur se KEPTSH për fazën substanciale e cila planifikohet të zbatohet për vitin shkollor 2017/18, ka planifikuar të përpilojë tekste shkollore komplet të reja për shkak të nevojës për ti përafuar ato me kurrikulën e re. Vendimi që të gjitha tekstet shkollore për vitin shkollor 2016/17 të ribotohen imponon shpenzime të mëdha buxhetore. Na është konfirmuar nga MASHT se vendimi që të gjitha tekstet shkollore të ribotohen ka krijuar kosto financiare prej rreth 7 milion €, që në krahasim me buxhetin e shpenzuar të vitit të kaluar për të njëjtin qëllim nuk rezulton të jenë krijuar kursime.<sup>21</sup> Pra, gjatë auditimit tonë kemi gjetur se ky vendim është marrë përkundër mungesës së një analize dhe rishikimi të mirëfilltë se cilat tekste shkollore duhet të ribotohen dhe cilat tekste mund të shfrytëzohen nga viti shkollor paraprak.

---

<sup>21</sup>Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, Qershor 2016, Grafiku 1, fq.2

## 4 Konkluzionet

Iniciativa për të rishikuar tekstet shkollore ishte e qëlluar dhe e domosdoshme. Megjithatë ne vlerësojmë se ky proces është karakterizuar me disa dobësi dhe nuk ka arritur ti realizojë tri objektivat e përcaktuara në fazën emergjente sipas qëllimit të synuar. Ne vlerësojmë se do duhej të kishte më shumë kohë në dispozicion si dhe komunikim e bashkërenditje të aktiviteteve në mes të pjesëmarrësve të përfshirë në procesin e rishikimit. KEPTSH do të duhej të kishte kritere më të qarta në bazë të të cilave do kryente rishikimet si dhe duhet të ishin më të kujdesshëm në marrjen e vendimeve se cilat tekste duhet të ribotohen duke pasur parasysh përqindjen e ulët të ndryshimeve, natyrën e ndryshimeve dhe faktin se disa prej teksteve nuk ishin rishikuar fare. Përveç kësaj, nuk ishte zgjedhur ndonjë alternativë tjetër nga anëtarët e KEPTSH për tekstet që kishin përqindje shumë të ulët të ndryshimeve apo të tjerat që nuk ishin pjesë e rishikimit. Në vend të kësaj, ata i kishin miratuar ato për ribotim. Gjithashtu, nuk është bërë ndonjë analizë e mirëfilltë nga KEPTSH apo MASHT lidhur me implikimet financiare të ribotimit të teksteve shkollore.

### *Procesi i rishikimit i karakterizuar me mangësi të shumta*

Formularët e plotësuar nga mësimmshënësist rezultuan me sugjerime që ishin kryesisht të natyrës teknike dhe në shumë pak raste të natyrës përmbajtësore.

Anëtarët e grupeve punuese të KEPTSH janë karakterizuar me mungesë të kapaciteteve profesionale dhe për këtë arsye nuk është lëvizur shumë përtej sugjerimeve të mësimmshënësve. Ata kanë përcjell tutje sugjerimet tek shtëpitë botuese në mënyrë që ato dhe autorët e teksteve të integrojnë sugjerimet e ofruara nga mësimmshënësist e shkollave dhe ti bëjnë ndryshimet tjera të natyrës përmbajtësore. Pas rishikimit të parë, KEPTSH ka ardhur në përfundim se shtëpitë botuese dhe autorët e angazhuar nga ta, me përjashtim të shumë pak rasteve, nuk kishin bërë përmirësime shtesë. Edhe pas rishikimit të dytë, kemi konstatuar se ka pasur shumë pak tekste që kanë pësuar ndryshime në krahasim me rishikimet nga rundi i parë.

Gjithashtu, ne vlerësojmë se kishte mangësi për sa i përket komunikimit dhe koordinimit të aktiviteteve të pjesëmarrësve në proces. Kjo është veçanërisht e dukshme në mes të anëtarëve të KEPTSH dhe shtëpive botuese përfshirë edhe autorët e teksteve të angazhuar nga to. Po ashtu, koha në dispozicion për kryerjen e këtyre aktiviteteve ishte e kufizuar, ndërsa numri i teksteve që kishte nevojë për rishikim ishte i madh.

### *Ndryshime të pakta teknike dhe jo përmbajtësore në tekstet e rishikuara shkollore*

Duke pasur parasysh se përqindja e ndryshimeve të bëra është shumë e ulët, si dhe për faktin se përmirësimet e bëra në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me gabime drejtshkrimore dhe gramatikore, është më se e qartë se vendimi i KEPTSH të ribotojë të gjitha tekstet shkollore për vitin shkollor 2016/17 ishte i nxituar. Sidomos, duke pasur parasysh se nga viti i ardhshëm shkollor 2017/18 planifikohet të fillojë zbatimin e kurikulës së re dhe përpilimi i teksteve

shkollore të reja, shumica e teksteve tashmë të “përmirësuara” do të dalin jashtë përdorimit nga viti i ardhshëm shkollor.

***Mungesa e adresimit të objektivës së lehtësimit të çantës shkollore nëpërmes procesit të rishikimit***

Objektivi për lehtësimin e çantës së shkollës nuk është adresuar gjatë procesit të rishikimit pasi që KEPTSH është fokusuar në adresimin e dy objektivave tjera. Njëkohësisht, numri i teksteve dhe vëllimi i tyre nuk është zvogëluar.

***Ribotim i teksteve të reja shkollore me kosto të lartë financiare***

Objektivi për të kursyer buxhetin jo vetëm që nuk është përmbushur, por në këtë vit shkollor është dëshmuar e kundërta. Ribotimi i të gjitha teksteve shkollore për vitin 2016/17 automatikisht do të thotë se porositë e teksteve janë bërë në bazë të numrit të përgjithshëm të nxënësve nëpër shkolla. Përveç që janë krijuar shpenzime të mëdha financiare, kjo ka krijuar sasi të mëdha të stoqeve të teksteve të vjetra shkollore.



## 5 Rekomandimet

Rekomandimet e dhëna më poshtë kanë për qëllim të sigurojnë se subjektet përgjegjëse krijojnë mekanizma të duhura dhe të qëndrueshme të rishikimit të teksteve për shkollë fillore.

Rekomandojmë MASHT, që përmes një udhëzimi administrativ apo ndonjë rregulloreje të brendshme, të:

- Definojë qartë përgjegjësitë e shtëpive botuese gjatë përgatitjes së dorëshkrimeve të teksteve shkollore;
- Obligojë secilën shtëpi botuese që të rishikojë dorëshkrimet e autorëve të teksteve nga redaktorët e vet e më pastaj ti dërgojë ato në MASHT;
- Për secilin dorëshkrim të emërojë recensentët dhe paraprakisht të definojë qartë dhe në mënyrë të shkruar kriteret në bazë të të cilave emërohen recensentët;
- Anashkalojë mundësinë e përcaktimit si anëtar të KEPTSH, autorë të teksteve shkollore, tekstet e të cilëve janë pjesë e procesit të rishikimit;
- Monitorojë në mënyrë të vazhdueshme punën e recensentëve dhe anëtarëve të KEPTSH për progresin e treguar në arritjen e objektivave të synuara. Sigurohet që recensentët e emëruar dhe anëtarët e Këshillit të ofrojnë raporte të detajuara me komente dhe sugjerime për rishikimet e teksteve shkollore.

Rekomandojmë KEPTSH, që:

- Të angazhojë në procesin e rishikimit ekspert të jashtëm të fushave të ndryshme të cilët janë kompetent për të kryer rishikimin e teksteve shkollore;
- Në rast të inicimit të proceseve të reja rishikuese të teksteve shkollore të monitorojë punën e recensentëve që përcaktohen nga MASHT për vlerësimin e dorëshkrimeve të teksteve të reja shkollore; - kjo është veçanërisht e rëndësishme për “fazën substanciale”, që planifikohet të kryhet për vitin shkollor 2017/18;
- Të bëjë planifikim të arsyeshëm kohor për të finalizuar procese komplekse të tilla si rishikimi i teksteve shkollore;
- Të sigurojë se do të ndërmerret një analizë e duhur dhe e detajuar financiare përpara se të merret një vendim për ribotimin e tërë tirazhit të teksteve shkollore;
- Përcaktohet formula e duhur për të matur përqindjen e ndryshimeve në tekstet shkollore dhe për botim të miratohen vetëm ato tekste që kanë pësuar ndryshime thelbësore; dhe
- Të sigurohet se brenda Këshillit ka komunikim të vazhdueshëm si dhe koordinim të aktiviteteve me të gjithë pjesëmarrësit që janë pjesë e tij.

## Shtojcat

### Shtojca 1

SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR	
PËRMIRËSIMET NË TEKSTE SHKOLLORE SIPAS TITUJVE TË SHPREHURA NË PËRQINDJE	
Titulli	Përqindja
Leximi 2	4.50%
Njeriu dhe natyra 3	8%
Edukata qytetare 3	18%
Leximi 4	12.4%
Edukata qytetare 4	13.02%
Njeriu dhe natyra 4	2%
Historia 5	10.70%
Gjuha shqipe 6	10.74%
Teknologjia 6	2.70%
Historia 6	9.10%
Leximi 7	7.80%
Historia 7	7.15%
Fizika 7	41%
Kimia 7	4.40%
Gjeografia 7	4.60%
Edukata qytetare 7	37.20%
Leximi 8	32.50%
Historia 8	1.13%
Gjeografia 8	25.20%
Leximi 9	3.27%
Gjeografia 9	22.20%
Historia 9	7.20%
Edukata qytetare 9	19.97%
<b>Mesatarja e përmirësimeve</b>	<b>13.25%</b>

## Shtojca 2

SHTËPIA BOTUESE "DUKAGJINI"	
PËRMIRËSIMET NË TEKSTE SHKOLLORE SIPAS TITUJVE TË SHPREHURA NË PËRQINDJE	
Titulli	Përqindja
Matematika 1	0%
Gjuha Shqipe 2	4.69%
Matematika 2	0%
Gjuha Shqipe 3	9.30%
Matematika 3	0%
Gjuha Shqipe 4	11.70%
Matematika 4	0%
Matematika 5	18.89%
Gjuha Shqipe 5	8.33%
Edukata qytetare 5	19.15%
Njeriu dhe Natyra 5	7.26%
Matematika 6	2.46%
Edukata qytetare 6	N/A
Fizika 6	9.85%
Biologjia 6	21.43%
Gjeografia 6	14.66%
Gjuha shqipe 7	21.88%
Matematika 7	0%
Teknologjia 7	15.38%
Biologjia 7	13.69%
Gjuha shqipe 8	9.52%
Matematika 8	2.50%
Teknologjia 8	10.83%
Edukata Qytetare 8	12.50%
Biologjia 8	26.25%
Fizika 8	5.92%
Kimia 8	14%
Gjuha Shqipe 9	4.82%
Teknologjia 9	46.36%
Biologjia 9	3.13%
Fizika 9	2.84%
Kimia 9	9.82%
<b>Mesatarja e përmirësimeve</b>	<b>11%</b>

### Shtojca 3

<b>SHTËPIA BOTUESE "ALBAS"</b>	
<b>PËRMIRËSIMET NË TEKSTE SHKOLLORE SIPAS TITUJVE TË SHPREHURA NË PËRQINDJE</b>	
<b>Titulli</b>	<b>Përqindja</b>
Lexim Letrar 6	1%
<b>Mesatarja e përmirësimeve</b>	<b>1%</b>